



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0729
Data e Vendimit: 23.09.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Flamuri V SH.P.K" kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Ngucat, Bellanicë, Temeqinë, Banjë, Senik, Carravranë, Damanek, Dragobil, Drenoc, Burim, Marali, Astrazub" me numër të prokurimit 625-26-7317-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Malisheves, Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 23.09.2026, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e jashtëafatshme dhe jo e plote, ankesa e OE "Flamuri V SH.P. K" me nr. të protokollit 2026/0729, e datës 22.09.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: "Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Ngucat, Bellanicë, Temeqinë, Banjë, Senik, Carravranë, Damanek, Dragobil, Drenoc, Burim, Marali, Astrazub" me numër të prokurimit 625-26-7317-5-1-1" me numër të prokurimit 625-26-7317-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Malisheves, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Malisheves që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si ne pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

II. Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar dëshmi që ka paguar tarifën e ankesës ashtu sic është e paraparë me nenin 118 të LPP-së.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 22.09.2026, ka pranuar ankesën Nr. 2026/0729 (Nr. protokolli) e OE "Flamuri V SH.P. K" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Asfaltimi i rrugëve në Fshatrat Ngucat, Bellanicë, Temeqinë, Banjë, Senik, Carravranë,

Damanek, Dragobil, Drenoc, Burim, Marali, Astrazub” me numër të prokurimit 625-26-7317-5-1-1” me numër të prokurimit 625-26-7317-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Malisheves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Nga provat e administruara OSHP konstaton se me datën 02.09.2026, Komuna e Malisheves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë B05. Hapja e ofertave ka qenë e paraparë të bëhet me dt. 22.09.2026.

Me datën 16.09.2026 (19:52), respektivisht me dt. 17.09.2026, OE "Flamuri V SH.P. K" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Vendimi i AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është publikuar me datën 21.09.2026.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse me datën 22.09.2026 është planifikuar të bëhet hapja e ofertave ndërsa kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 17.09.2026 (sepse sipas nenit 5 të LPP-së ankesa e parashtruar me datën 16.09.2026 (19:52) bartet për datën 17.09.2026), andaj kërkesa për rishqyrtim është në kundërshtim me nenin 108/A si dhe nenin 60.1. a) të RrPP-së.

OSHP sqaron se kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit OSHP konstaton se ankesa është e jashtëafatshme në AK andaj Autoriteti kontraktues – Komuna e Malishevës, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Poashtu sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: “1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare. 2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet”.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, pasi që OE nuk ka paguar tarifën për ankesë OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë jo të plotë siç parashihet me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së me saktësisht nenin 118 par 1 dhe 2 të LPP-se si dhe nenin 69 par 2 të Rregullores për Prokurim Publik.

Kryesues i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimiit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**
- **OE - FLAMURI V SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: